

Prishtinë, 18.04.2017**Drejtuar:** Znj. Valdete Daka, Kryetare e Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ)**Nga:** OJQ Germin**Tema:** Zgjedhjet në Kosovë dhe Pjesëmarrja e Diasporës

E nderuara zonja Daka,

Më 30 mars 2017, organizata jo-qeveritare Germin, në kuadër të iniciativës *Dialogu i Strukturuar për të Drejtat e Diasporës* ka mbajtur takimin virtual me temën *Zgjedhjet në Kosovë dhe Pjesëmarrja e Diasporës*. Në këtë takim ishin prezent:

1. Ministri i Diasporës, z.Valon Murati;
2. Adelina Muhaxheri nga Zvicra (Politikane);
3. Enis Halimi nga KQZ;
4. Ganimet Bajraktari nga Austria (Aktiviste);
5. Ruben Avxhiu, nga ShBA (Kryeredaktor i gazetës shqiptaro-amerikane Illyriapress); dhe
6. Faton Topalli, deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje.

Diskutimi u moderua nga Jetmir Bakija, i cili është koordinator i Bordit Këshillues të Germin-it.

Diaspora shqiptare vazhdon të jetë kontribuues kryesor në zhvillimin e vendit tonë. Përgjatë viteve, ata kanë pasur një rol kyç në çlirimin, pavarësimin dhe stabilitetin ekonomik. Duke marr parasysh që mërgata shqiptare përbën një prej grupeve më të mëdha sociale në Kosovë, angazhimi i tyre në zgjedhje është i rëndësishëm. E drejta e votës sot atyre ju garantohet me ligj, të cilët për ta shfrytëzuar duhet t'i kalojnë disa pengesa burokratike dhe t'i respektojnë afatet e shkurtra. Për fat të mirë, sot kemi një diasporë e cila si asnjëherë më parë është mirë e informuar dhe mirë e integruar në vendet ku jetojnë.

Andaj, duke u bazuar sipas një hulumtimi nga UNDP, 2014, thuhet se të paktën 300 000 mërgimtarë gëzojnë të drejtën e votës në Kosovë, mirëpo më pak se 1500 e tyre kanë votuar në zgjedhjet e fundit. Kjo shifër e ultë, është pasqyrim se sistemi i tanishëm i votimit nga jashtë lë shumë për të dëshiruar. Edhe nëse pjesëmarrja e mërgatës është aq sa ajo e qytetarëve që jetojnë në Kosovë (46.31%), vota e tyre mund të luaj një rol kyç në zgjedhjen e kandidatëve për kryetarë/e komunal.

Është me rëndësi të përmendim se të gjithë panelistët gjatë diskutimit virtual, u pajtuan se pjesëmarrja e mërgatës në votime është me rëndësi sepse e fuqizon kontributin e madh që ajo e ka dhënë për zhvillimin e Kosovës deri më tani. Po ashtu, panelistët komentuan dhe rekomanduan:

- Metoda të ndryshme për të lehtësuar votimin nga jashtë si: Votimi online, votimi fizik, votimi në ambasada/konsullatat;
- Diaspora të ketë përfaqësues në Komisionin Qendror Zgjedhor;
- Të zgjatet afati për të dërguar fletëvotimet nga jashtë;
- KQZ të inkurajojë më shumë mërgimtarët të votojnë në zgjedhjet e Kosovës.

Prandaj, duke marr parasysh që mërgata shqiptare përbën një prej grupeve më të mëdha sociale në Kosovë, angazhimi i tyre në zgjedhje është i rëndësishëm.

Në vazhdimësinë e aktiviteteve për ta ngritur zërin e diasporës për të drejtat e tyre politike e sociale, Germin është duke u takuar me bashkatdhetarët tanë në disa shtete të botës, për të marrë informata të hollësishme për mendimet dhe perceptimet e diasporës. Më e rëndësishmja, këto takime do të jenë të dobishme për të organizuar idetë sa i përket ngritjes së vetëdijes për të drejtat shoqërore dhe politike të diasporës. Andaj, duke marr parasysh që diaspora gjithmonë ka qenë një faktor i rëndësishëm për

të mbledhur përkrahje ndërkombëtare për Kosovën si dhe duke investuar për përmirësimin e shoqërisë kosovare, Germin do të krijojë Grupin Avokues të Diasporës. Qëllimi i këtij grupi joformal është të bashkëpunojë me institucionet publike të Kosovës për të përparuar përfshirjen e diasporës në qeverinë e Kosovës.

Shpresojmë që pikat e përmendura më lartë, do të shërbejnë si pikënisje për një diskutim më të gjerë për angazhimin e mërgatës shqiptare në proceset politikëbërse në Kosovë, dhe të hapim diskutim më të gjerë rreth votimit të diasporës, dhe lehtësimin e procedurave aktuale për votim.

Të bashkangjitur gjeni editorialin e hartuar nga Kaltrina Kusari nga OJQ Germin me titull [Rëndësia e votës së mërgimtarëve shqiptarë](#) dhe opinionin e Ruben Axhiut [A e do vërtetë diaspora të drejtën për të votuar?](#), të dy shkrimet të dala nga diskutimi.

Me respekt,

Behar Xharra

Drejtor Ekzekutiv në Germin

